



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1127/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore - bërja e fushatës përmes rrjetit social Facebook, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura me datë 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuar ankesa Anr.1127/2021 e datës 14.11.2021, e paraqitur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 300.00 (treqind euro), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

**II. DETYROHET** Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar më datë 14.11.2021 ankesën Anr.1127/2021 nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 13 Nëntor 2021, rreth orës 23:30 kanë vërejtur se mbështetësit e Subjektit Politik LVV, Znj Argjentina Grazhdani thyer heshtjes zgjedhore në rrjetin social Facebook.

Më tej parashtruesi i ankesës ka theksuar se statusi i postuar në rrjetin social Facebook përmbante shkrimin “*LDK janë bërë bashkë me PDK, kundër LVV-së në Prishtinë. Krejt bizneset dhe financuesit e dikurshëm të dy partive tash po e përkrahin Përparim Ramën. Krejt Prishtina e din çka kanë bo mafia e ndërtimit në Prishtinë me vite te tana. Nuk kemi me leju rikthimin e gjunglës së betonit. Arben Vitia dhe pikë*”. Sipas parashtruesit të ankesës këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika 1 dhe 36 pika 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme-LZP dhe ka kërkuar nga PZAP-i, që subjekti politik LVV, të sanksionohet sipas legjisllacionit në fuqi.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës ka bashkangjitur dy fotografi të printuara nga rrjeti social-Facebook.

Në përgjigjet në ankesë të datës 14.11.2021, nga Subjektit Politik LVV, theksohet se kjo ankesë është e paqëndrueshme për faktin se fotografitë e bashkangjitura si provë nuk është specifikuar data dhe dita e postimit. Pra në asnjë mënyrë nuk janë të vërteta pretendimet e ankuesit se është shpërndarë postimi gjatë heshtjes zgjedhore, dhe se i njëjti postim përmban ka thirrje për nxitje të urrejtjes.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, pas shqyrtimi të shkresave të lëndës ka konstatuar se Subjekti Politik LVV, me seli në Prishtinë, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, kanë bërë fushatë zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës te Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 14.11.2021, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse postimi i kontestuar si në ankesë ishte ende aktiv.

Në raport me pretendimet e Subjektit Politik LVV, lidhur me faktin se fotografitë e bashkangjitura si provë nuk është specifikuar data dhe dita e postimit, Paneli i vlerësoi si të pabazuara ngase nga dëshmitë e bashkangjitura në ankesë shihet qartë se postimi ka ndodhur në ditën e votimit më datë 14.11.2021 në ora 15:26, veprim i cili ndalohet me dispozita ligjore, ku theksohet se subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohet të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit dhe gjatë ditës së votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, dhe se postimi i bërë ka qenë ende aktiv postimi është vërtetuar pas verifikimeve të bëra nga PZAP, andaj si e tillë konsiderohet se është bërë shkelje e heshtjes zgjedhore në ditën e votimit prandaj edhe se ankesa e Subjektit Politik LDK, është e bazuar.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli mori faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba LVV, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe ka marrë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën

zgjedhore dhe faktin se subjekti politik në fjalë ka bërë përpjekje që ti njoftoj mbështetësit e saj lidhur me respektimin e legjislacionit në fuqi me qëllim të evitimit të shkeljeve gjatë heshtjes zgjedhore në ditën e votimit, e të cilat rrethana do të ndikonin në lehtësimin e gjjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ *Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it, brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.*”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1127/2021 më datë 15.11.2021

**Kryesues i Panelit**  
**Ferit Xhaferi**



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***